

NJOFTIM PËR FILLIMIN E PROCEDURËS SË KONKURIMIT PËR LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL, PËR 1 (NJË) VEND TË LIRË PUNE NË POZICIONIN “SEKRETARE PRANË PROKURORËVE” NË KATEGORINË IV-1

Në mbështetje dhe në zbatim të neneve 70 – 83 e vijues të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe mbi bazën e strukturës organike të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier”, miratuar me urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 19, datë 30.01.2024, dërguar struktura organike me shkresën nr. 160/4, datë 31.01.2024, të Sekretarit të Përgjithshëm, me qëllim plotësimin e vendit vakant në zbatim të strukturës shpall procedurën për“ lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në Prokurorinë Fier”, për pozicionin:

- 1 (një) vend “sekretare pranë prokurorëve” në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, kategoria e pagës IV-1.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori të regjistruar në listën e nëpunësve civile të prokurorisë, ose ata të cilët kanë të drejtë të rikthehen ose të transferohen!

PËR TË DY PROCEDURAT (LËVIZJE PARALELE/PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL NË PROKURORI FIER) APLIKOHET NË TË NJËJTËN KOHË!

Afati për dorëzimin e dokumentave do të jetë data 31.12.2024.

PËRSHKRIMI PËRGJITHËSUES I PUNËS

- Sekretaria e prokurorisë kryen funksione administrative dhe procedurale në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Sekretaria e prokurorisë ushtron në veçanti funksionet e mëposhtme:
 - a) vërteton aktet e prokurorisë dhe lëshon vërtetime ose kopje të njësuara me origjinalin. Kur përdoren pajisje regjistrimi ose pajisje që kryejnë funksione të ngjashme, sekretari garanton që regjistrimi ose riprodhimi është origjinal dhe i paprekur;
 - b) ndihmon në mbajtjen dhe administrimin e dosjeve;
 - c) ndihmon në mbajtjen e regjistrave, si dhe për regjistrimet në regjistra dhe ndihmon në mbajtjen dhe përdorimin e mjeteve teknike, audiovizive dhe kompjuterike atje ku këto janë të disponueshme;
 - d) bashkëpunon me autoritetet kompetente për çështje të taksave dhe tarifave;

e) ndihmon në krijimin e statistikave të prokurorisë, sipas kriterëve të përcaktuara për këtë qëllim dhe për saktësinë e të dhënave; dhe

dh) ushtron çdo detyrë tjetër të caktuar me ligj.

➤ Kryen veprimtari të tjera të parashikuara/renditura në rregulloren standarde të organizimit dhe funksionimit të prokurorisë, miratuar me Urdhërin e Prokurorit të Përgjithshëm nr. 164, datë 18.12.2020 “*Për miratimin e rregulloreve standarde të organizimit dhe funksionimit të Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm*”, i ndryshuar.

➤ Kryen funksione të tjera të caktuara me ligj, akte nënligjore, si dhe me urdhëra të drejtuesit dhe/ose kancelarit të prokurorisë.

1. LËVIZJA PARALELE.

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në Prokurori ose ata që kanë të drejtë të rikthehen ose transferohen, sipas nenit 77 të ligjit 97/2016, etj.

I. KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA.

I.1. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të jetë shtetas shqipëtar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejnë detyrën;
- e) Të jenë nëpunës të së njëjtës kategori brenda sistemit të Prokurorisë;
- f) Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- g) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundravajtje penale me dashje
- h) Të mos jetë në ndjekje penale;
- i) Të kenë rekomandim “shume te mire” nga titullari i insitucionit përkatës që ka punuar për herë të fundit, për rezultatet në punë;

I.2. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta:

- a) Të jenë diplomuar në drejtësi;
- b) Të ketë të paktën një vit përvojë pune në fushën e kërkuar, të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvojë tjetër profesionale që lidhet me prokurorinë;
- c) Të ketë njohuri në një nga gjuhët e BE-së (preferohet anglisht);
- d) Të ketë aftësi komunikuese dhe për punë në grup;
- e) Të ketë aftësi për të krijuar marrdhënie pune efektive dhe bashkëpunuese me eprorët dhe kolegët;
- f) Të ruajë sekretin hetimor;

- g) Të ketë njohuri të plota të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në republikën e Shqipërisë”, dhe Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit nr.9131/2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, dhe Kodit të Punës, dhe ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, dhe Rregullores standarte të organizimit dhe funksionimit të Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm...”, miratuar me urdhërin nr. 164, datë 18.12.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm.
- h) Të plotësojë kriteret ligjore për pajisjen me Certifikatë të Sigurimit të Personelit nga DSIK.

II. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht me postë ose dorazi në kryesekretari, brenda datës 31.12.2024, në adresën: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Fier, Lagjia “29 Nëntori”, Rruga: “Todi Shkurta”, Fier, ose elektronikisht në adresën e email: Eni.Begaj@pp.gov.al, dokumente si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron;
- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>, shoqëruar me foto;
- Fotokopje e letërnjoftimit/pasaportës së vlefshme;
- Fotokopje e diplomës dhe listës së notave (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njësimi nga MAS), njësuar me origjinalin nga noteri;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) dhe /ose vërtetim nga Insituti i Sigurime Shoqërore dhe/ose vërtetim nga punëdhënësi;
- Dokument/vërtetim nga insitucioni që vërteton se është nëpunës i Prokurorisë brenda të njëjtës kategori me pozicionin “sekretar”.
- Dokument/vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi (dokument nga institucioni);
- Rekomandim mbi rezultatet në punë të dhëna nga titullari i insitucionit përkatës që ka punuar për herë të fundit.
- Fotokopje të certifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Dëshmi penaliteti dhe vetëdeklarim për vërtetimin e gjendjes gjyqësore, sipas linkut <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/formulari-i-deklarimit-gjendja-gjyqesore.pdf>
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore, që është i aftë për punë;
- Dokumentacion tjetër, mbi trajnimet, kualifikimet (nëse ka);
- Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaja nëse ka;
- Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës;
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit;
- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ka çështje në proces.
- Vërtetim nga Shërbimi Përmbarimor.
- Vërtetim i njësisë administrative
- Certifikatë të Sigurimit të Personelit (nëse ka).
- Listë inventari e plotë e nënshkruar e dokumenteve të paraqitura;

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara sjell skualifikimin e kandidatit.

III. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK.

III.1. Verifikimi paraprak, i përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe kritereve të veçanta në shpalljen për konkurim, do të kryhet pas datës 31.12.2024, në ambientet e Prokurorisë Fier, dhe menjëherë pas verifikimit do të shpallet lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, të shpalljes për konkurim.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, do të njoftohen nëpërmjet adresës së e-mail-it të depozitur nga kandidatë për shkaqet e moskualifikimit të tyre;

Shpallja do të bëhet në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë;

IV. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET KONKURRIMI.

Kandidatët do të vleresohen në lidhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.
- Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe normat tekniko-profesionale metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre;
- Ligjit nr. 10/2023 “Per informacionin e klasifikuar”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;
- Ligjin nr. 9367, datë 07.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;
- Kodin e procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë;
- Ligjin nr.9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe aktet nënligjore në zbatim;
- Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;
- Rregulloren standarte të organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm...”, miratuar me urdhërin nr. 164, datë 18.12.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, e ndryshuar.

V. AFTËSI PËR TË:

- a) Aftësi praktike për të ofruar shërbim profesional në përputhje me legjislacionin që rregullon administrimin e dokumentacionit, duke krijuar dhe ruajtur sipas ligjit, regjistrat përkatës;

- b) Aftësi për të ofruar ndihmë teknike në fushën e protokollimit të dokumenteve, si dhe për të koordinuar, kontrolluar dhe bashkëpunuar, duke shkëmbyer ide dhe mendime për të argumentuar propozimet përkatëse për përmirësimin e praktikës së punës;
- c) Aftësi në përpunimin tekniko-shkencor të dokumenteve në bazë të kriterëve që normojnë punën e protokollimit të dokumentacionit;
- d) Fleksibilitet në bashkëpunimin, komunikimin dhe prezantimin shërbimit të tij/saj, me metoda të reja që nuk bien ndesh me ligjin dhe dinjitetin e punonjësit.

VI. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE.

Vlerësimi maksimal 100 pikë.

➤ **Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:**

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën profesionale të përgjithshme në pozicionin përkatës, vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e drejtësisë, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, rezultatet e vlerësimit të punës, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 20 pikë.

➤ **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 30 pikë.

➤ **Vlerësimi i testimit me shkrim do të jetë 50 pikë.**

Komisioni i Pranimit rendit kandidatët fitues me më shumë pikë dhe që kanë marrë më shumë se 70 përqind të pikëve totale të vlerësimit, në listën e kandidatëve fitues.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e lëvizjes paralele, do të marrin informacion, për fazat e mëtejshme për:

- datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi (intervista) dhe testimi me shkrim.

2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË PROKURORINË FIER

Në rast se nga pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ky pozicion është vakant, atëherë ky pozicion

është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil të Prokurorisë Fier. Këtë informacion do ta merrni në faqen e Prokurorisë Fier.

I. KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NË SHËRBIMIN CIVIL NË PROKURORINË FIER DHE KRITERET E VEÇANTA.

I.1. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për pranim si vijon:

- Të jetë shtetas shqipëtar;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejnë detyrën;
- Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo një kundravajtje penale me dashje
- Të mos jetë në ndjekje penale;
- Të kenë rekomandim “shume te mire” nga titullari i insitucionit përkatës që ka punuar për herë të fundit, për rezultatet në punë;

I.2 Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- Të jenë diplomuar në drejtësi;
- Të ketë të paktën një vit përvojë pune në fushën e kërkuar, të njohur si praktikë profesionale ose çdo lloj përvoje tjetër profesionale që lidhet me prokurorinë;
- Të ketë njohuri në një nga gjuhët e BE-së (preferohet anglisht);
- Të ketë aftësi komunikuese dhe për punë në grup;
- Të ketë aftësi për të krijuar marrdhënie pune efektive dhe bashkëpunuese me eprorët dhe kolegët;
- Të ruajë sekretin hetimor;
- Të ketë njohuri të plota të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në republikën e Shqipërisë”, dhe Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, dhe ligjit nr.9131/2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, dhe Kodit të Punës, dhe ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, dhe Rregullores standarte të organizimit dhe funksionimit të Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm...”, miratuar me urdhërin nr. 164, datë 18.12.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm.
- Të plotësojë kriteret ligjore për pajisjen me Certifikatë të Sigurimit të Personelit nga DSIK.

II. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidati duhet të paraqesë zyrtarisht, me postë ose dorazi në kryesekretari, brenda datës 31.12.2024, në adresën: me postë në adresën: Lagjia “29 Nëntori”, Rruga: “Todi Shkurta”, Fier, ose elektronikisht në adresën e email: Eni.Begaj@pp.gov.al, dokumentet si më poshtë:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkurron;
- Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <http://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhezime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>, shoqëruar me foto;
- Fotokopje e letërnjoftimit/pasaportës së vlefshme;
- Fotokopje e diplomës dhe listës së notave (për diplomat jashtë vendit, të përcillet njësimi nga MAS), njësuar me origjinalin nga noteri;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë) dhe /ose vërtetim nga Insituti i Sigurime Shoqërore dhe/ose vërtetim nga punëdhënësi;
- Dokument/vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi (dokument nga institucioni);
- Rekomandim mbi rezultatet në punë të dhëna nga titullari i insitucionit përkatës që ka punuar për herë të fundit.
- Fotokopje të çertifikatave të kualifikimit (nëse ka);
- Dëshmi penaliteti dhe vetëdeklarim për vërtetimin e gjendjes gjyqësore, sipas linkut https://ëëë.drejtësia.gov.al/ëp-content/uploads/2018/10/formulari-i-deklarimit_gjendja-gjyqesore.pdf
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore, që është i aftë për punë;
- Dokumentacion tjetër, mbi trajnimet, kualifikimet (nëse ka);
- Dëshmi të njohurive të gjuhës së huaja nëse ka;
- Fotokopje e kartës së identitetit/pasaportës;
- Kontaktet (numër telefoni dhe adresë email) dhe adresën e plotë të vendqëndrimit;
- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria që nuk ka çështje në proces.
- Vërtetim nga Shërbimi Përmbarimor.
- Vërtetim i njësisë administrative
- Çertifikatë të Sigurimit të Personelit (nëse ka).
- Listë inventari e plotë e nënshkruar e dokumenteve të paraqitura;

Mosparaqitja e plotë e dokumenteve të sipërcituara sjell skualifikimin e kandidatit

III. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

III.1 Verifikimi paraprak:

Verifikimi paraprak i përmbushjes së kushteve të përgjithshme dhe kritereve të veçanta në shpalljen për konkurim, do të kryhet pas datës 31.12.2024 dhe do të shpallet lista e kandidatëve që plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, të shpalljes për konkurim.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e përgjithshme dhe kriteret e veçanta, do të njoftohen nëpërmjet adresës së e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

Shpallja do të bëhet në faqen zyrtare të internetit të Prokurorisë.

IV. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET VLERËSIMI DHE INTERVISTA

IV.1 Kandidatët do të testohen me shkrim në lidhje me :

- *Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;*
- *Ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.*
- *Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 "Për arkivat" dhe normat tekniko-profesionale metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tyre;*
- *Ligjit nr. 10/2023 “Per informacionin e klasifikuar”, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;*
- *Ligjin nr. 9367, datë 07.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike;*
- *Kodin e procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë;*
- *Ligjin nr.9131/2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, si dhe aktet nënligjore në zbatim;*
- *Ligjin nr.152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij;*
- *Rregulloren standarte të organizimit dhe funksionimit të Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm...”, miratuar me urdhërin nr. 164, datë 18.12.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm, e ndryshuar.*

IV.2. Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

V. MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi maksimal 100 pikë.

➤ Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën profesionale të përgjithshme në pozicionin përkatës, vitet e përgjithshme të përvojës profesionale në sektorin e drejtësisë ose përvojën profesionale që lidhet me fushën e drejtësisë, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, rezultate e vlerësimit të punës, si dhe çertifikimin pozitiv ose për vlerësimet e rezultateve individuale në punë në rastet kur procesi i çertifikimit nuk është kryer.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 20 pikë.

➤ **Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:**

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 30 pikë.

➤ ***Vlerësimi i testimit me shkrim do të jetë 50 pikë.***

Komisioni i Pranimi rendit kandidatët fitues me më shumë pikë dhe që kanë marrë më shumë se 70 përqind të pikëve totale të vlerësimit, në listën e kandidatëve fitues.

V.1. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT.

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Prokuroria Fier do të njoftojë kandidate individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet nëpërmjet adresës së e-mail-it të dhënë prej tyre. Prokuroria Fier do të shpallë fituesin edhe në faqen zyrtare të Prokurorisë.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimi në shërbimin civil të Prokurorisë, do të marrin informacion, për fazat e mëtejshme për:

- datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak;
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurrimi (intervista) dhe testimi me shkrim.

Fier, më datë _____.12.2024

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM FIER